

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.04(382)

PRILL 2020

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

NDERIMI



Rrahman PARLLAKU

VELIAJ:
Parllaku
“Simbol i
qytetit të
Tiranës”

FAQE 2

VLERESIMI



Kolonel Ing. Myfit GUXHOLLI

**GJENERAL
PARLLAKU
E DREJTOI
OBVL-në ME
PËRKUSHTIM
QYTETAR**

FAQE 2

IN MEMORIAM



Nga Agron Sejamini

*Largohet nga jeta, nënkolonel
Shefqet Sejamini, specialisti i
talentuar i xhenjos, shef Kate-
dre në Akademinë Ushtarake*

**PËR TIM VËLLA,
SHEFQETIN!**

FAQE 6 dhe 7

Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershëm dhe patriot

ILIR META: Gjeneral Parllaku, një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht

Emblemë e qëndresës dhe e disidencës

Halil RAMA

Këtë 17 prill, Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit, Rrahman Parllaku do t'i festonim 101-vjetorin e ditëlindjes. Por, ndonëse s'e kemi më fizikisht midis nesh, Ai u përjetësua me jetën dhe veprën e tij heroike dhe do t'ju flasë brezave si legjendari i pavdekshëm. Në historinë e popullit shqiptar të 100 viteve të fundit, gjeneral Rrahman Parllaku është përjetësuar si emblemë e qëndresës dhe e disidencës. Mjaftojnë për këtë të lexosh qindra mesazhet e personaliteve publike e politike, si dhe të qytetarëve të thjeshtë nga Shqipëria, Kosova e diaspora, në librin e ngushëllimeve që Protokolli Zyrtar i Shtetit hapi në ceremoninë e lamtumirës së gjeneral Parllakut më 16 shtator 2019, e përbashkëta e të cilave është atdhedashuria, si i vetmi testament që na la Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit.

“Nëse dikush duhet quajtur sfidant i kohërave, ky është pa asnjë dyshim gjeneral Rrahman Parllaku. E sfidoi varfërinë në bjeshkët e Sharrit, sfidoi pushtimin e vendit me armë, shpirt e zemër; luftoi për çlirimin e Shqipërisë, sfidoi diktaturën dhe u la brezave një shembull të madh virtyti dhe idealizmi”.

VËJON NË FAQEN 9

PERKUJTIMORE

**PERSONALITET
POLIEDRIK
I KOMBIT SHQIPTAR**

Nga Trifon Llupo

FAQE 4



• *“Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve”*

FAQE 3

TAKIMI

**OVLANÇ të Kosovës, film dokumentar
për burrështetasin Fadil Hoxha**



Lufta e Dytë Botërore dhe lufta e UÇK-së, ngjarjet më të ndritura në historinë e kombit shqiptar

Nga Bashkim Hisari

FAQE 11

URIMI

**Gjeneral Piro Ahmetaj
uron mirëseardhjen
e Maqedonisë së Veriut
në NATO**



FAQE 12

DOSSIER

**Shkolla “Skënderbej“,
një trup pedagogjik
cilësor dhe studentë të
përkushtuar**



LIBRI

**“Oficeret shqiptare në
rrjedhën e historisë“,
publicistikë me vlere, do-
kumentare e historike**

ENGJELL MUSAI
Drejtor i gazetës “Telegraf”

FAQE 10

ANALIZA

Kryebashkiaku Veliaj vlerëson ish-kryetarin e OBVL si simbolin e gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike

Parllaku “Simbol i qytetit të Tiranës”

- *Një vit më parë, kryetari i Bashkisë Tiranë. Z.Erion veliaj nderoi Gjeneral Parllakun me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”, si patriot që luftoi fashizmin, si figurë emblematike e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe si gjenerali që sfidoi regjimin e diktaturës komuniste*

Gjeneral Rrahman Parllaku mbetet mbi të gjithë një hero i gjallë dhe krenari e qytetit. Para një viti, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”, një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste.

Këshëtu gjenerali legjendë përjetësohet si “Simbol i qytetit të Tiranës”, si patriot që luftoi fashizmin, figurë emblematike e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, gjenerali që sfidoi regjimin e diktaturës komuniste, dhe Hero i Popullit, titull që diktatura komuniste ia hoqi, por historia ia përjetësoi.

Gjenerali Rrahman Parllaku ishte ndër të paktët partizanë që jetoi dhe dëshmoi histori të tre kohëve, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist. Ndaj dhe para një viti kryebashkiaku veliaj u shpreh se gjeneral Parllaku është simboli i njerëzve që pavarësisht sakrificave, ka dhuruar vetëm dashuri dhe mirësi. “Si djalë i ri që je, vetëm 100 vjeç, them se i bën nder qytetit tonë të të shpallim simbol të Tiranës. I bindur se Ai gëzonte respekt me mirënjohje nga të gjithë qytetarët, të majtë të djathtë, Veliaj tha



se: “Duhet të kuptojmë se në historinë e këtij vendi edhe të mirat, por edhe të këqijat, ia kemi bërë vetë njëri-tjetrit. Edhe i kemi ngritur njerëzit që kanë sakrifikuar, edhe i kemi ulur, por ja ku jemi prapë sot në këmbë.”. Në këtë ceremony mbresëlënëse Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku kujtoi betejat në luftën për çlirimin e Tiranës. Ai shprehu mirënjohjen ndaj kryebashkiakut Veliaj për këtë vlerësim që iu et në përvjetorin e e 100-të lindjes.



OBVL e themeluar dhe drejtuar 998 nga Dr.Ymer Dishnica dhe General Rrahman Parllaku, gjatë këtyre dy dekadave të fundit ka shënuar një histori suksesi

Gjeneral Parllaku e drejtoi OBVL-në me përkushtim qytetar

- *Gjeneral Parllaku, që nga vitit 1998 e deri sa ndërroi jetë më 15 shtator 2019 e drejtoj me përkushtim organizatën tonë të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, duke e bërë atë deri anëtare të denjë të Federatave Botërore e Europiane të Veteranëve*

KOLONEL ING.MYFIT GUXHOLLI
Kryetar i OBVL

Gjeneral Rahman Parllaku – Hero i Popullit dhe nderi i Kombit, i cili ka lindur më 17 prill 1999, në fshatin Novosej të Lumës, ishte i vetmi ish-drejtuës i formacioneve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i Ushtrisë Shqiptare që sfidoi pushtuesin dhe diktaturën komuniste.

Ai njihet si komandant i njësiteve guerile të qytetit të Vlorës deri më 28 nëntor 1943, dhe më pas si drejtues në brigadat e 3-të, 8-të dhe 12-të Sulmuese.

Me çlirimin e Kosovës, më 22 nëntor, në qytetin e Pejës merr urdhrin e emërimit komandant i Divizionit

të 5-të dhe u gradua kolonel.

Nga 20 dhjetori i vitit 1944 deri në mars të vitit 1945, forcat e komanduara nga Parllaku në bashkëveprim me forcat jugosllave çliruan krahinën e Sanxhakut. Me ndërprerjen e luftimeve, forcat e Divizionit të 5-të e të 6-të Sulmues u kthyen në Kosovë. Më 14 prill të vitit 1945, kur ndodhej në Mitrovicë, ai mori urdhrin e emërimit komisar i Korparmatës së 2-të në Berat. Më pas kryen funksione të pushtetit në qarkun e Shkodrës dhe pasi kreu studimet në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sovjetike “Vorošilov” kreu me devotshëmi e përkushtim funksione të rëndësishme në Ushtri, deri zëvendës Ministrë i Mbrojtjes e zëvendës shef i shtabit të Përgjithshëm.

Parllaku, ka qenë zgjedhur deputet i Kukësit në Kuvendin Popullor për 7 legjislatura rresht, që nga viti 1945 deri në vitin 1973. Por me gjithë kontributin dhe meritat e tij të padiskutueshme, Gjeneral Parllaku u arrestua dhe dënua nga ish nomenklatura socialkomuniste për pjesëmarrje në të ashtuquajturin “puç ushtarak”, me 25 vjet heqje lirie, nga të cilat 16 vjet e tri muaj i vuajti në burg (nga dhjetori i vitit 1974 deri më 17 mars të vitit 1991). Në rekursin e bërë nga Parllaku, Gjykata e Kasacionit vendosi, më 20 korrik



të vitit 1994, prishjen e vendimit të 5 nëntorit të vitit 1975 të Gjykatës Ushtarake, që e cilësoi atë fajtor dhe pushimin e akuzave të mësipërme.

Me dekretin Nr.8525, datë 02.04.2014, Presidenti i Republikës i ka akorduar gjeneral Parllakut dekoratën “Nderi i Kombit”, me motivacionin: “Drejtuës i talentuar i luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, qëndrestar i paepur në burgjet e diktaturës komuniste, veprimtar i rrallë në mbështetje të demokracisë, si dhe vendosjen e forcimin e shtetit ligjor”.

Gjeneral Parllaku, që nga vitit 1998 e deri sa ndërroi jetë më 15 shtator 2019 e drejtoj me përkushtim organizatën tonë të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, duke e bërë atë deri anëtare të denjë të Federatave Botërore e Europiane të Veteranëve.

Organizata jonë e themeluar dhe drejtuar deri në vitin 1998 nga Dr.Ymer Dishnica – Nderi i Kombit, gjatë këtyre dy dekadave të fundit që drejtohet nga gjeneral Parllaku ka shënuar një histori suksesi.



NDERIMI

Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershëm dhe patriot

ILIR META: Gjeneral Parllaku, një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht

Gjeneral Rrahman Parllaku, ishte dhe mbetet i veçantë, sepse si shumë rrallë tjetër në udhëtimin e tij shekullori ka jetuar të gjitha: mjerimin, varfërinë, luftën, paqen, fuqinë e pushtetit dhe persekutimin e pamëshirshëm të regjimit totalitar. Një vit më parë në ceremoninë që Presidenti i Republikës, SHT Z. Ilir Meta organizoi në selinë e Presidencës në 100-vjetorin e lindjes të gjeneral Rrahman Parllakut, ndër të tjera u shpreh se rrugëtimin 100-vjeçar Ai e ka përshkruar përmes fjalës e veprës së tij, duke mbetur një monument e pasuri kombëtare e pa eksploruar plotësisht.

Ne nderohemi me Gjeneral Parllakun, pasi sipas kreut të shtetit, në jetën dhe veprën e tij janë ulur këmbëkryq urtësia e burrit të malësisë, trimëria, shpirti i lirisë dhe atdashedashuria e luftëtarit antifashist dhe e komandantit partizan, si dhe angazhimi qytetar plot përkushtim.

“Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve”,-u shpreh Presidenti Meta.

Në vlerësimin e kreut të shtetit shqiptar, Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit Rrahman Parllaku simbolizon figurën e e partizanit fitimtar, të komandantit dhe gjeneralit, por edhe të mbijetuarit të një brezi sakrificash e privacionesh të jashtëzakonshme. Fati e deshi që Ai të kalonte një jetë të lavdishme në tri epoka; partizan dhe komandant legjendar antifashist; qëndrestar i burgjeve komuniste, si dhe një veteran me ‘arsye dhe zë të kthjellët’ në mbështetje të demokratizimit



• *“Si uji i kristaltë i lumit të bjeshkës ka rrjedhur jeta e këtij njeriu që sfidoi kohët dhe regjimet, me përkushtimin ndaj kombit, i pathyeshëm në betejat që iu imponuan apo i zgjodhi që të bënte përgjatë 100 viteve”*

të vendit pas viteve 1990.

I ngjizur në urtinë e odave lumjane dhe i burrëruar në Labëri, përgjatë një shekulli Ai mbetet “dëshmitar i gjallë” për të gjitha ngjarjet e një shekulli.

Rrallë gjen shembuj të personalitetit ku të jenë jetësuar në mënyrë kaq mjeshtërore vetitë e karakterit të një patrioti, të një ushtaraku të mençur, fisnik, të ndershëm dhe patriot.

Gjenerali i përjetësuar në një dokumentar televiziv

Një dokumentar i Radio-televizionit Publik Shqiptar (RTSH) i realizuar para një viti me rastin e 100-vjetorit të ditëlindjes së Heroit të Popullit, gjeneral Rrahman Parllaku, që është shfaqur disa herë dhe vazhdon të shfaqet ndiqet me interes të jashtëzakonshëm nga teleshikuesit. Ky dokumentar me skenar nga Xhelil Aliu, Halil Rama e Sakip Cami, me regji të Bajram Hoxhës, ka patur audidencë të jashtëzakonshme.

I intervistuar disa herë gjatë dokumentarit, gjeneral Parllaku nuk harron të vlerësojë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si pjesën më të rëndësishme të historisë së shtetit shqiptar, por me kujdesin që të mos vendoset shenja e barazisë mes kësaj lufte dhe regjimit komunist që u vendos pas saj në Shqipëri. Vetë Parllaku ishte një nga viktimat që kaloi 20 vjet në burgjet e komunizmit si pjesë e grupit armiqësor të ushtrisë.

“Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare nuk ishte lufta më e lavdishme e popullit shqiptar, siç e thonë, sepse më e lavdishme ishte lufta e Skënderbeut dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit. LANÇ-i ishte një luftë e lavdishme. Bëjnë gabim ata që ngatërrojnë këtë luftë me komunizmin. Luftën e bënë bijtë dhe bijat e nënave, nga 15 vjeç e lart, unë isha më i madhi i luftës, 20 vjeç. Prandaj, lufta nuk duhet mohuar kurrë”, shprehet në dokumentar gjeneral Parllaku. Një pjesë interesante e dokumentarit është dhe një debat i gjeneralit me Lordin Robertson, ish-ministrin e Mbrojtjes së Britanisë së Madhe e më vonë dhe sekretar i Përgjithshëm i

NATO-s. Ishte periudha kur në Maqedoni, UÇK luftonte për të drejtat e shqiptarëve dhe shtetet perëndimore i cilësonin ata si terroristë. Me një ton të ashpër, në një nga takimet e Shoqatës Shqiptare të Atlantikut, ku prezent ishte dhe Lordi Robertson, gjeneral Parllaku i kërkoi që luftëtarët shqiptarë në Maqedoni të mos cilësohen terroristë, por luftëtarë të lirisë, pasi ata nuk kanë bërë genocid dhe nuk kanë vrarë civilë, por po luftojnë për të drejtat dhe liritë e tyre si pakicë shtetformuese.

Nisur nga vlerësimet e shumta, në ditëlindjen e tij të 100-të, por edhe në ceremoninë e lamtumirës së tij më 16 shtator 2019, dokumentari mund të pasurohet. Për t’iu shërbyer brezave si një dëshmi autentike për të Luftën e lavdishme Antifashiste nacionalçlirimtare.

Mosiu: Shqipëria nuk bëhej pa kontributin e njerëzve si Rrahman Parllaku

Ish-Presidenti i Republikës Alfred Moisiu vlerëson kontributin e gjeneral Parllakut, si gjatë luftës për çlirimin e Shqipërisë, ashtu edhe për betejat për çlirimin e Kosovës. “Shqipëria nuk bëhej pa kontributin e njerëzve si Rrahman Parllaku dhe bashkëkohësve të tij. Ta ruajmë Shqipërinë me gjithë problemet që ka sepse kjo baltë është më e ëmbël se mjaltja. LANÇ-i është lufta e lavdishme. Lufta e Skënderbeut, Lufta e Dytë Botërore dhe lufta e UÇK-së janë tri luftëra ku shqiptarët luftuan për vetene tyre dhe as për turqit dhe as për Napoleonin, dhe I fituan. Prandaj, luftën ta vlerësojmë siç duhet dhe të mos e përdhosim”, shprehet ndër të tjera ish-Presidenti Moisiu.

PËRKUJTIMORE

Personalitet poliedrik i Kombit Shqiptar



TRIFON LLUPO
Kolonel në Pension

Më 15 Mars, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Popullit Shqiptar përkujtoi me respekt e nderim, Kryetarin e Nderit, Gjeneralin Rrahman Parllaku.

U bënë 6 muaj nga ndarja fizike e Gjeneral Rrahmanit, por Ai jo vetëm për ne antarët e OBVL, por edhe për çdonjerin që ka punuar apo e ka njohur ne takime e biseda, figura e Gjenerali nuk i largohet nga mendja e shpirti sepse Ai ishte dhe mbetet një ndër figurat e shquara të Kombit Shqiptar.

15 Shtatori i vitit 2019, është data dhe dita kur pushoi së rrahuri zemra më se 100 vjeçare e Gjeneral Lejtenant Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit.

Me jetën e tij prej mëse një shekull, Ai i dha vendit shumë më tepër se çmori prej tij dhe me ndershmërinë, trimërinë, shpirtmadhësinë, përkushtimin, fisnikërinë, atdhedashurinë për mbarë trojet shqiptare, por edhe me pamjen fizike të një kreshniku që e karakterizonte, Ai ishte dhe mbetet modeli i të gjitha vlerave dhe virtyteve të Kombit Shqiptar. Duke qenë një personalitet me jetë

të gjatë dhe me këto veti e vyrtyte, jeta e tij kaloi me shumë tallaze, por kurrë ai nuk u përkul, por u qendroi burrërisht, nuk e njohu kurrë ndonjëherë dekurajimin dhe demoralizimin. Pra kurajua, durimi, shpirti i sakrificës dhe guximi me të cilat ai i përballoi pa u thyer asnjëherë ishin "armët" e tij gjatë gjithë jetës së tij shekullore. Me këto "armë" ai përballoi aksionet e Njësiteve guerile në Vlorë si dhe betejat luftarake me fashistnazistët deri në çlirimin e plotë vendit, ditë, të cilën ai e festoi në Kosovë sepse drejtonte luftimet si Komandant i Divizionit të V-të, deri në Vishegrad të ish Jugosllavisë, duke e rreshtuar e futur Shqipërinë në Frontin e madh të Aleancës Anglo-Sovjeto-Amerikane, në Luftën e dytë Botërore.

Gjeneral Rrahmani, në çdo rrethanë që u ndodh edhe kur u godit poshtërsisht, duke e mbyllur pas hekurave me 25 vjet burgim, Ai kur doli nga burgu nuk predikoi

kurrë hakmarrje, por Ai ka treguar një tolerancë të rrallë sepse Ai i ka takuar personalisht hetuesit e gjyqtarët që e dënuan, sepse Ai ishte i bindur në pafajsinë e vet, dhe këta prokuror e gjykatës ishin urdhëruar nga partia, pra zbatonin urdhrin e partisë për dënimin e grupit të ashtuquajtur puçist në Ushtri.. Këtë të vërtetë dhe fakt, tashmë e ka bërë publik edhe Prokurori i Përgjithshëm i diktaturës komuniste Rrapi Mino, i cili në disa numra rradhazi, në gazetën Panorama ka deklaruar se për Grupin puçist të Ushtrisë nuk kishte asnjë fakt e provë për tradhëti ndaj Atdheut, por ishte gjyq politik. Me këto deklarime Rrapi Mino konfirmon Vendimin e drejtë të Gjykatës së Kasacionit në vitin 1994, ku Trupi gjykues dha vendimin për pafajsinë e plotë të General Rrahmanit, duke ia kthyer të gjitha çka i ishin hequr: Titujt, Urdhërat e Medaljet.

Unë, që po shkruaj këto radhë për Gjeneral Rrahmanin, e kam

Ai i përmbahej një rregulli, të cilin e kishte bërë detyrim personal.

"Unë theksonte shpesh Gjenerali, kur intervistohet nga gazetar të ndryshëm për probleme dhe çështje nga më të ndryshmet, flas dhe gjykoj vetëm për ato ngjarje dhe probleme që i kam parë dhe jetuar vetë dhe nuk flas dhe komentoj mbi bazën e të thënave apo të dëgjura".

Veprimtaria e General Rrahmanit i përket disa periudhave historike të Shqipërisë. Ajo përfshinë periudhën e Mbretërisë deri në vitin 1939, - Periudhën e Luftës Nacional Çlirimtare 1939-1944, Periudhën e diktaturës komuniste 1944-1990 dhe Periudhën e Demokracisë 1991-2019., ku në çdo periudhë historike të Shqipërisë dhe Kombit Shqiptar Ai ka dhënë kontributin e tij të vyer, duke i qendruar dhe i shërbyer vetëm Popullit shqiptar dhe Kombit shqiptar.

Kur shprehem se Ai i ka shërbyer Kombit Shqiptar, kam parasysh se ai ishte një ndër 4 komandantët e një-sive më të mëdha, gjatë Luftës An-



njohur këtë Personalitet legjendar, që në vitin 1972, kur shërbeja në Drejtorinë e Zbulimit të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa Gjenerali ishte Zëvendës Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura deri në Gusht të vitit 1974. Nga detyra që kisha në Drejtorinë e Zbulimit, me Gjeneralin takohesha çdo mëngjes sapo fillonim punën dhe ishte një fat i madh për mua që m'u dha mundësia të punojë edhe njëherë me këtë gjeneral, edhe më nga afër, si sekretar i OBVL, gjatë kohës që Gjeneral Rrahmani drejtoi për 20 vjet Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.

Kushdo që ka punuar dhe e njohu nga afër Gjeneral Rrahmanin, shpesh është detyruar t'i bëjë pyetjen vetes se a mund të ketë ndonjë 100 vjeçar në të gjithë Globin, që të rrezatonte aq energji e freski intelektuale dhe kujtesë brilante, i cili me aftësi poliedrike i jepte zgjidhje çdo problemi sado i vështirë dhe i koklavitur. Gjenerali konkludonte drejt sepse

tifashistë Nacional Çlirimtare, pra ishte komandant i Divizionit të V-të, që zhvilloi luftimet jashtë kufijve shtetëror të Shqipërisë, në Kosovë e deri në Vishegrad,, duke ndjekur këmba-këmbës bishën naziste dhe duke kontribuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë.

Gjeneral Rrahman Parllaku ishte gjenerali i vetëm i gjallë i Luftës Dytë Botërore, i cili e kaloi shekullin dhe arriti edhe vitin 2019, Ai do ishte një monument i gjallë i kremtimit të 75 vjetorit të Çlirimit të Atdheut sepse Ai lindi, u rrit dhe mbeti patriot.

Ai si për të vazhduar nderimin dhe respektimin e Luftës Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar, për të cilën sakrifiko rininë dhe rrezikoi jetën e tij si 70 mij bijë dhe bija të Formacioneve Partizane Shqiptare, u nda nga kjo jetë dhe u varros më 16 Shtator 2019, datën e mbajtjes së Konferencës së Pezës, një nga ngjarjet më të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar.

DOSSIER

Në përvjetorët e saj Shkolla "Skënderbej" është dekoruar me shumë Urdhëra e Medalje

Shkolla "Skënderbej", trup pedagogjik cilësor dhe studentë të përkushtuar

Ing. Myfit GUXHOLLI

Kur ende nuk ishte shuar jehona e betejave fitimtare kundër okupatorit nazifashist, me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor u çel e para shkollë ushtarake e pionierëve të luftës. Traditat luftarake të popullit tonë brez pas brezi dhe patriotizmi i lartë i pionierëve, pjesëmarrja në luftimet e çetave, batalioneve e brigadave kalitën shpirtin e tyre duke i ndërgjegjësuar për detyrën e re. Kjo bëri që shkolla ushtarake (e kadetëve) të merite fizionominë e një shkolle të mesme.

Kjo shkollë që e nisi rrugën e saj si fidanishte e Ushtrisë Kombëtare u sistemua në ambjentet ku është Akademia Ushtarake "Skënderbej". Nxënësit e parë të kësaj shkolle ishin ish partizanët nën moshën 15 vjeçare që vinin nga brigadat partizane dhe ata djem e vajza të dëshmorëve të LANÇ nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Ata erdhën në shkollë me uniformën që mbanin në luftë dhe me armët personale, pushkë, automatikë e pistoletat.

(Ndërsa jo pjesëmarrësit në luftë mbanin uniformën kadife blu). Shkolla përbëhej nga komanda e Shtabi. Komandanti i parë i shkollës ishte Mehmet Dermeni – kapiten i I-rë, komisar toger Dule Pashaj, Shefi i degës mësimore, kapiten i parë Vangjel Doga e kapiten Thoma Frashëri. Në fillim u krijuan tre batalione me komandant e komisar kapiten Shuaip Shazi, kapiten Miço Kola e kapiten Filip Stefani.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

U krijuan dy brigada: brigada e IV-të me studentë ish pjesëmarrës në luftë, me komandant Myfit Guxholli dhe komisar Gafer Shyti; (komandant i batalionit të parë Vasfi Rexhepi).

Brigada e I-rë me uniformë kadife blu: Ylber Sevrani, komandant dhe Xhevdie Golemi, komisar... Batalioni i parë, komandant Qemal Tuzi dhe Faik Meko. Veçojme studentet partizane Veronika Murzeku, Katerina Prifti etj.



INAGURIMI I SHKOLLËS

Në inagurimin e shkollës më 28 Mars 1945 mori pjesë gjeneral major Spiro Moisiu – komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Skënderbegasit, pjesëmarrës në luftë, armët i mbanin nën jastëk dhe nuk i dorëzonin në depo. Nga komanda e shkollës dhe ajo e studentëve u përgatit një lojë për marrjen e armëve të studentëve. Në malin e Dajtit ishte shkruar një parullë fashiste me gërma të mëdha "DVX" që duhej prishur. Në vend të saj duhej një parullë e re. Shkuam në malin e Dajtit, zbatuam detyrën dhe u kthyem në shkollë, kur ç'të shohim: armët ishin mbledhur e dorëzuar në depo. Pakënaqësia dhe nervozizmi ishte i madh.

RIORGANIZIMI

Në 5-vjetorin e saj shkolla u riorganizua dhe u përpiluan programet dhe tekstet. Për fatin e mirë u plotësua trupi pedagogjik dhe ai komandues. Shumica e pedagogëve ishin të përgatitur në shkollat e Perëndimit. Me respekt kujtojmë pedagogët: Barie Kopliku, Halit Narazuni, Hysni Alimerko, Ahmet Tufa, Eftimiadhi, Stavri Angjeli, Valeria Drenova e shumë të tjerë. Puna e kualifikuar e trupit pedagogjik dhe komandës, përkushtimi i nxënësve dhe studentëve bindën

Trupi pedagogjik cilësor dhe studentët e përkushtuar, kabinetet e reja, labororet, ambjentet e komandës dhe të një jetese normale bënë që shkolla "Skënderbej" të rriste treguesit cilësorë dhe sasiorë. Cilësitë dhe virtytet e skënderbegasve si besa, trimëria, solidariteti, dashuria e devotshmëria për Atdheun, familjen e shokun ishin më të çmuarat për skënderbegasit që në çdo çast ecnin në gjurmët e lavdishme të LANÇL.

drejtuesit e Ministrive të Arsimit dhe Mbrojtjes që shkolla të vlerësohej dhe të merrte emrin "Shkolla e Mesme Ushtarake Skënderbej". Për arsyen se shkolla nuk kishte klasa të dyta e të treta të mesme, skënderbegasit dërgoheshin në gjimnazin "Qemal Stafa" si psh Pavlo Dede, Myfit Guxholli, Agron Starova etj. Trupi pedagogjik cilësor dhe studentët e përkushtuar, kabinetet e reja, labororet, ambjentet e komandës dhe të një jetese normale bënë që shkolla "Skënderbej" të rriste treguesit cilësorë dhe sasiorë. Cilësitë dhe virtytet e skënderbegasve si besa, trimëria, solidariteti, dashuria e devotshmëria për Atdheun, familjen e shokun ishin më të çmuarat për skënderbegasit që në çdo çast ecnin në gjurmët e lavdishme të LANÇL. Këto cilësi e virtyte u demonstuan më së miri gjatë provokacionit të gushtit kur monarkofashistet grekë tentuan të preknin kufirin tonë shtetëror. Shumë skënderbegas kërkuar të shkonin vullnetarisht në mbrojtje të kufirit, por Ministria e Mbrojtjes konsideroi pjesërisht kërkesën e tyre.

SHKOLLE SHUMEDIMENSIONALE..

Në përvjetorët e saj Shkolla "Skënderbej" është dekoruar me shumë Urdhëra e Medalje. Pedagogët, komanduesit dhe studentët e kësaj shkolle kanë dhënë një kontribut të madh



edhe në sektorë të tjerë si në art, sport, kulturë, diplomaci e shkencë. Pikërisht për këtë e meriton të quhet shkollë shumëdimensionale. Krenaria dhe lavdia e saj u përhap në gjithë vendin sepse moto e saj ishte "Atdheu mbi të gjitha". Ajo u dallua për ndjenjë patriotike dhe dije në shërbim të Atdheut. Nga kjo shkollë kanë dalë jo vetëm kuadro ushtarakë të të gjitha rangjeve, por edhe të sektorëve të tjerë pasi ajo ishte jo vetëm një fidanishte e Ushtrisë Kombëtare, por edhe përhapëse e dijes e kulturës në të gjitha fushat e jetës. Ajo ka përgatitur e nxjerrë nga nëntogerë deri gjeneralë, nga teknikë deri doktorë e profesorë. Në këtë përvjetor jubilar të saj ia vlen të përmendim skënderbegasit: Luan Rama, ish ministër i Mbrojtjes, Bujar Nishani, ministër, gjeneral Kostaq Karoli, ish shef i Shtabit të Përgjithshëm, kandidati i Shkencave Ushtarake Pandeli Stoja, prof.Dr.Përparim Lika, dhe prof. dr.Eduard Isufi. Po ashtu shef shërbimi Ing.Nuri Jaho, studjues e përkthyes Ing.Guri Shyti, shef katedre Ing. Pasho Alimerko, mjeshtër sporti-shef katedre, kolonel Petrit Murzaku, shef katedre – kolonel tankist Aleko Koka, pilot i klasit të parë – komandant Aki Jupasi, pilot i klasit të parë Petrit Malindi, komandant korpusi Izet Murati etj. Në plejadën e personaliteteve që ka nxjerrë kjo shkollë bëjnë pjesë shkrimtari Shpend Topollaj, shefi i shërbimit topografik Gafer Shyti, shef shtabi grupimi Dr. as. Mik Hado, kolonel Ylber Sevrani (kuader i lartë i marinës ushtarake), Prof.Dr.Gjergji Aleksi, kolonel Proletar Hasani (historian), gjeneral major Armando Vinçani, artistët Milto Vako e Ndrek Zefi, sportisti Petrit Çallsi, shef shërbimi n/kolonel Hqmet Shehi, diplomati Hajro Limaj (kolonel), kolonel Xhavit Xhepa-Drejtor i Drejtorisë së Xhenjos e shumë të tjerë.

Ne ish skënderbegasit e parë, jemi krenarë që mbaruam atë shkollë, duke vazhduar më pas edhe shkolla të larta, universitete dhe akademi, brenda dhe jashtë vendit. Përsëritës në këtë jubile të saj tupin pedagogjik, komandant e shkollës dhe gjithë oficerët që na edukuan dhe mësuam. Nder dhe lavdi heronjve e dëshmorëve të luftës e pas luftës.

**Ish komandant i Brigadës së skënderbegasve të luftës*



IN MEMORIAM

Largohet nga jeta, nënkolonel Shefqet Sejamini, specialisti i Për tim vëlla, Shefqetin!

• I lindur dhe rritur, në periudhën e luftës për liri, ku familja jonë ka qenë mbështetëse dhe kontribuese e lëvizjes çlirimtare, doemos edhe ai fëmijë ka ushqyer adhurim dhe simpati për partizanët me uniformë e armatim ushtarak

Nga Agron Sejamini

MË SHUMË SE SA NJË HOMAZH PËR TIM VËLLA...

Mu dhimbs shumë, ikja e tim vëllai... Më theri në shpirt! Vazhdoj të mbetem peng i një mjegullnaje dëshpërimi dhe dhimbjeje. Kurrë nuk e besoja, se do të ulesh për të shkruar diçka... Më e pakta, do të mërzisja dhe vetë atë që nuk i ka dashur lëvdatat dhe mburjet. Mirëpo, shkak dhe shkëndijë frymëzimi, u bë një status i hedhur në facebook, nga kolegu i tij, Zabit Cuku. Dhe në vijim, shumë komente që shprehnin keqardhje dhe konsiderata. Ndaj këtyre personave, ndjehemi borxhli dhe i falenderojmë që u bënë pjesë e pikëllimit tonë. Gëzime të kenë në familjet e tyre!

Por, edhe më shumë na emocionuan dhe ngushëlluan shpirtin tonë të lënduar, kolegët dhe miqtë e tij, me ato fjalë të thjeshta, sa edhe të singerta. Mes tyre, Muharrem Dardha, shpreh konsiderata për një "... ushtarak të nderuar!"; Aleks Nasto, pohon se "Ishte një njeri me vlera!"; Ibrahim Gargaj, e kujton, si "Ushtarak i shkëlqyer dhe pedagog shëmbullor në Akademi. Jepte taktikë xhenjere... I paharruar, i nderuari pedagog!"; Agim Muhollari, përcjell pikëllim për humbjen e vëllait të xhenjos, "Ngushëllime familjes së Çetit, siç e thërrisnim ne shokët dhe vëllezërit xhenjer. Ngushëllime për vëllain tonë xhenjer! Thjeshtësia, dashuria për armën e xhenjos ka qenë vlera, virtyti i Çetit tonë të dashur që ne shokët e tij, do ta kujtojmë gjatë, sa të rrojmë!"; Bajram Mane, mëson me "...keqardhje të madhe për largimin nga jeta të xhenjerit të talentuar dhe pedagogut të rrallë, Shefqet Sejamini!"

Vazhdojnë, më pas, me nota trishtimi për këtë lajm të padëshiruar, Syl Ismaili, Ramazan Leka, Hysni Bahiti, Gjergj Tako, Leonard Xhani, Baki Zyla, Sali Frenku, Muhamed Tabaku, Qamil Çipa, Perparim Veliu, Maksim Fejzulla, Alim Sula, Petrit Rama, Dine Xheka, Jashar Basho, Arben Oshafi, Luan Saliko, Mustafa Derishi, Ali Bushi, Bernard Zotaj, Telha Dorzi, Nazmi Çela, Saba Duçkallari, Agim Lleshi, Arqile Kokëdhima, Nikollë Tushi, Dalan Jaupaj, Fitim Kumani, Bujar Pasmaçi, Hekuran Rapaj, Hamit Gojani, Bibë Kaza, Arben Sopaj...

Nuk do e desha kurrë këtë mënyrë prezantimi me Ju, por edhe nuk mund të heshtja pas xhestit tuaj fisnik, ndërsa rreshtuat këto ndjesi të singerta njerëzore për njeriun tonë të dashur, vëllain tim të madh, më shumë se vëlla-Shefqetin. Për të mira dhe për gëzime ua shpërblefshim që na lehtësuat dhimbjen. Në këto momente edhe shpirti i Shefqetit, gëzon nga ndjeshmëria juaj...



Në moshën 17-vjeçare, mësues në Lubonjë, më 1954

• Iku pa lajmëruar, pa u ndjerë! Ashtu si u shfaq në 83 vite jetë, duke mos dashur të binte në sy. Një jetë e përmbushur më së miri, me sukses dhe dinjitet njerëzor që na bën krenar dhe na largon mungesën e tij

Në të afërme dhe pjesëtarëve të familjes, kjo prezencë shpirtërore, na e "ngjall" njeriun e shtrenjtë që humbëm. Nga kjo, përschiptje shoqërore, natyrshëm të pushton një ndjesi e fortë pozitiviteti. Vëllai është vëlla sepse je i lindur nga një nënë, por kur vëlla e bëjnë edhe kolegët apo njerëzit që ai ka njohur në jetë, doemos edhe krenohesh. Në rastin tim, madje edhe "të detyrohesh" dhe të frymëzohesh, për t'u ulur dhe hedhur këto rreshta. Sepse më shumë se sa një homazh për tim vëlla, ky shkrim do desha të ishte mesazh. Gjithkush, duhet të motivohet në përditshmërinë e tij, nga virtytet dhe vlerat më të vyera njerëzore. Kusht moral, që të bën të ndjehesh i vlerësuar dhe i respektuar dhe akoma më tepër, të mbetesh në kujtesën e të gjallëve, i nderuar dhe i paharruar.

KUR MIKËPRITJA TRADICIONALE SHQIPTARE ISHTE NJË HAP PARA VARFËRISË DHE SKAMJES...

E thashë më sipër, pse mu ndez frymëzimi, por ama ndjehem edhe me fat sepse kam plot detaje për t'i dhënë jetë këtij shkrimi...

Shefqeti, ishte më i madhi, i dy motrave dhe pesë vëllezërve. Shtatë fëmijë që shtatëfishuan shqetësimet dhe detyrimet për babanë tone, i lindur për të qenë punëtor! Plotësimi i nevojave më elementare të jetesës, e detyronin atë, të ishte në më të shumtën e 24 orëve jashtë shtëpisë. Shpesh herë, pa i mjaftuar edhe koha fizike, për t'i kryer të gjitha proceset e punës që përfshinte dita. Duke qenë i vetëm mashkull në familjen tonë, të bekuar me shumë fëmijë, por dhe të rënduar me aq shumë varfëri, i duhej të mbante plugun dhe parmendën për të pluguar dhe mbjellë; të prashiste dhe të vadiste; të korre atë pak misër e grurë që kultivonte; të mbarështonte dhe të kujdesej për atë tufë dhensh e dhish që jepnin qumështin për bulmet, mishin për pastërmanë e dimrit dhe leshin për të bërë shtrojet e veshjet e domosdoshme, për të përballuar të ftohtit. Të një dimri shumë të ashpër që në Rehovën time, zgjaste deri në pesë muaj... Ishte koha, kur për tim Atë, qyteti i Korçës, pesë orë larg më këmbë, ishte bërë më "i afërti" front pune, për të tregtuar sasi të pakta artikujsh bulmeti, dru zjarri dhe fije të holla pishe... Me ato pak të holla që siguronte nga kjo tregti, kthehej në shtëpi me atë pak sasi kripe, sheqeri apo orizi të domosdoshëm, më shumë për të pritur dhe përcjellë bujarisht mysafirët, se sa për të ushqyer fëmijët e shtëpisë. Kanë qenë kohë kur mikëpritja tradicionale shqiptare ishte një hap para varfërisë dhe skamjes.

Në të tilla vështirësish mbijetese dhe ngarkesë punësh fizike, më e madhja lehtësi dhe më e dëshiruara mbarësi, për ata prindër do të ishte lindja sa më shpejt i një fëmije. Fatlumë për atë vatër dhe prag shtëpie, nëse vinte në jetë djalë... Edhe në rastin tonë, sa më shpejt të rritej Shefqeti, aq më shpejt do të zvogëlohej pesha dhe lodhja e babait. Mirëpo, për tim Atë, kjo ditë nuk erdhi asnjëherë! Me largpamësinë dhe mënçurinë e tij, ai e largoi



Student në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, Tiranë më 1956

edhe më shumë, duke e pozicionuar djalin e madh në frontin e dijes dhe të shkollimit. Për vete dhe për babanë, Shefqeti, e realizoi këtë ëndërr atërore, në nivelet më të larta të mundësisë, duke mbërritur deri në pedagog të Akademisë Ushtarake.

POR, LE TA PËRSHKRUAJMË SADOPAK KËTË UDHËTIM DINJITËZ TË SHEFQETIT TONË...

Pas mbarimit të shkollës fillore në fshatin e lindjes, Rehovë të Vithkuqit, ai kreu me rezultate të shkëlqyera shtatëvjeçaren në Lubonjë. Kjo ishte edhe arsyeja e akordimit të një burse studimi për në Shkollën Pedagogjike në Shkodër. Pas përfutimit të njohurive bazë pedagogjike, natyrisht jo program i plotë, por i shkurtuar për arsye të nevojave shumë të ngutshme që kishte sektori i arsimit, në moshën 17 vjeçare, ai bëhet pjesë e stafit pedagogjik të shkollës shtatëvjeçare në Lubonjë. Tashmë, nxënësit e klasës së parë që ai kishte në kujdestari, janë të moshës mbi 70 vjeçare... Vetëm kaq pak, ishte kontributi i tij në fushën e arsimit, sepse për tjetërkund u ndez pasioni dhe dëshira e djaloshtit rehoval...

I lindur dhe rritur, në periudhën e luftës për liri, ku familja jonë ka qenë mbështetëse dhe kontribuese e lëvizjes çlirimtare, doemos edhe ai fëmijë ka ushqyer adhurim dhe simpati për partizanët me uniformë e armatim ushtarak. Kujtojmë se Makërza, sheshi mes pishave, ku u rreshtua për herë të parë në formacion ushtarak Brigada e Parë Sulmuese, ndodhet dhjetë minuta larg fshatit dhe është pjesë e territorit të Rehovës. Për fëmijët e asaj kohe kjo jehonë e jashtëzakonshme dhe ajo pjesëmarrje masive partizanësh, natyrisht që la mbresa të pashlyera në kujtesën e tyre. Tema kryesore e bisedave në çdo familje, ishte lufta dhe Atdheu. Pa harruar edhe tjetrën, që treva jonë e Kolonjës, në këtë epope të lavdishme pati luftëtarë trima, një pjesë e të cilëve pak vite më vonë, do bëheshin gjeneralë të shquar në ushtrinë tonë popullore. Kjo jehonë trimash dhe strategësh ushtarakë, me sa duket do ketë nxitur atë dëshirë të zjarrtë të Shefqetit, duke e detyruar të lërë mësuesinë, për të filluar në Tiranë, Shkollën e Bashkuar të Oficerave. Me sa më kujtohet, për garanci në miratimin e dokumentacionit zyrtar, im Atë, është ndihmuar edhe nga njëri prej gjeneralëve kolonjarë, mik i familjes tonë. Kjo "braktisje" e mësuesisë, nuk e trishtoi tim Atë, i cili më e pakta, do të humbiste një rrogë shteti, ndihmë e madhe në përballimin e nevojave ekonomike për familjen. Në largpamësinë e tij prindërore, ecuria e mbarë e Shefqetit, do të ishte edhe një mundësi e artë për t'u shkëputur nga fshati edhe djemtë e të tjerë, në atë kohë ende të vegjël. Ashtu, sikurse ndodhi në të vërtetë!

Kishte peshë dhe autoritet, sikurse ishte dhe shumë e preferuar nga tërë brezi i ri, uniforma e ushtarakut në shoqërinë shqiptare të asaj kohe. Në rastin e Shefqetit,

(Vijon në faqen 7)



I sapodiplomuar oficer, Shefqeti i pari majtas

IN MEMORIAM

talentuar i xhenjos, shef Katedre në Akademinë Ushtarake



E fundit foto në karrierën ushtarake, më 1992

Udhëtimi dinjtoz i Shefqet Sejaminit...

• Aftësitë e tij drejtuese dhe njohuritë bashkëkohore për armën e xhenjos, të aplikuara me aq efikasitet dhe mjeshtëri në terren, tërhoqën vëmendjen e dikasterit qendror të Mbrojtjes, për t'i krijuar mundësinë këtij ushtaraku të talentuar, që të njëjeh edhe me programet më elitare në fushën e vet, duke i ofruar shansin e shkëlqyer, për të vazhduar studimet në Akademinë Ushtarake. Në këto auditore, zelli dhe dashuria për specialitetin e xhenjos, u shfaqën sistematikisht gjatë përvetësimit të programit dyvjeçar dhe u shpërblyen ditën e diplomimit, kur Shefqeti, iu akordua Çertifikata me vlerësimin “Shkëlqyer”. Nuk u mjaftua me kaq komanda e Akademisë Ushtarake, por atë javë i dha jetë urdhërit, ku bënte të ditur emërimin e Shefqet Sejaminit, pedagog në Katedrën e Xhenjos të këtij institucioni të lartë mësimor dhe shkencor ushtarak. Pas disa muajsh, ai hodhi një tjetër hap cilësor, duke u bërë drejtues i kësaj katedre, niveli më i lartë që mundi të gëzonte meritueshëm në karrierën ushtarake, 38 vjeçare

Vijon nga faqja 6

shtatlartë dhe simpatik, shtohet edhe më shumë hijeshia dhe madhështia e ushtarakut shqiptar në sytë e publikut të gjerë.

Pas diplomimit oficer, Shefqeti, nisi udhëtimin e gjatë të ushtarakut, pozicionuar në specialitetin e xhenjos. Vendshërbimet e para kanë qenë Erseka, Maliqi, Korça dhe Pogradeci. Në çdo detyrë që iu besua, ai shfaqti vetitë e ushtarakut të disiplinuar, të papërtuar dhe mbi të gjitha, të drejtuesit të talentuar dhe të pasionuar në profilin e tij. Repartet që ai drejtoi, u shquan në shumë misionet ushtarake dhe civile, siç ishin asgjësimi i fushave të minuara gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore dhe kontributi i vyer në shumë objekte të rëndësishme të veçantë, ku volumi më i madh i proceseve të punës, përballohej nga specialiteti i xhenjos.

Aftësitë e tij drejtuese dhe njohuritë bashkëkohore për armën e xhenjos, të aplikuara me aq efikasitet dhe mjeshtëri në terren, tërhoqën vëmendjen e dikasterit qendror të Mbrojtjes, për t'i krijuar mundësinë këtij ushtaraku të talentuar, që të njëjeh edhe me programet më elitare në fushën e vet, duke i ofruar shansin e shkëlqyer, për të vazhduar studimet në Akademinë Ushtarake. Në këto auditore, zelli dhe dashuria për specialitetin e xhenjos, u shfaqën sistematikisht gjatë përvetësimit të programit dyvjeçar dhe u shpërblyen ditën e diplomimit, kur Shefqeti, iu akordua Çertifikata me vlerësimin “Shkëlqyer”. Nuk u mjaftua me kaq komanda e Akademisë Ushtarake, por atë javë i dha jetë urdhërit, ku bënte të ditur emërimin e Shefqet Sejaminit, pedagog në Katedrën e Xhenjos të këtij institucioni të lartë mësimor dhe shkencor ushtarak. Pas disa muajsh, ai hodhi një tjetër hap cilësor, duke u bërë drejtues i kësaj katedre, niveli më i lartë që mundi të gëzonte meritueshëm në karrierën ushtarake, 38 vjeçare.

NË KRYE TË CIKLIT TË SPECIALITETEVE NË SHKOLLËN E ZALL HERRIT

Në zbatim të strategjisë dhe projekteve të shumta që ideoi sistemi i asaj kohe, për shtimin e masave mbrojtëse, ndaj ndonjë “sulmi të mundshëm imperialist - revizionist” u çel Shkolla e Kuadrove Rezervistë në Zall Herr, efektiviteti i të cilës e kalonte numrin e një mijë kursantëve, përgjatë dy viteve që shteronte programin e plotë mësimor - stërvitor. Një pjesë e konsiderueshme e këtij kontigjenti që arrinte rezultate të larta, emëroheshin oficerë aktivë në forcat tona të armatosura. Që në ditën e çeljes së kësaj shkolle ushtarake, në krye të Ciklit të Specialiteteve që përfshinte, degët e xhenjos, kimisë dhe nderlidhjes, u emërrua Shefqeti, mision të cilin ai e përmbushi me sukses të plotë duke justifikuar plotësisht besimin e drejtuesve të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Natyrsh, me idenë dhe mbështetjen e tij, edhe unë munda të jem kursant i kësaj shkolle në ciklin mësimor 1977-1979, me synimin për tu bërë oficer aktiv. Sigurova rezultatet e larta në degën e Artilerisë Tokësore, por dëshira finale, nuk plotësua për shkak të kërkesave të



Me bashkëshorten, Bukuriye, ditën e fejesës

shumta. Atëherë u dëshpërova shumë, ndërsa më pas nuk ndjeva pendesë, sepse si dhuratë nga Zoti, m'u krijua mundësia të realizoj ëndrrën e fëmijërisë që ishte... gazetaria!

As për Shefqetin dhe as për mua, nuk ishte e lehtë ajo bashkëjetesë dyvjeçare. Vërtetë, ndjeheshim të lumtur dhe të ngopur shpirtërisht, por po aq ndjeheshim edhe të detyruar për të qenë në vendin dhe lartësitë e duhura, para të tjerëve, tek të cilët ngjallnim sa kureshtje aq edhe vëmendje. Unë, më e pakta, nuk duhej t'i krijoja shqetësime dhe më e shumta, me disiplinën ushtarake dhe rezultatet e larta në mësim, duhet ta bëja krenar para kolegëve të vet. Ia dola ta lumturoj! Ia dola t'i ledhatoj sedrën dhe krenarinë që në individualitetin e tij ishte pasion. Ia dola që në çdo hap suksesi që arrita në atë shkollë ushtarake, të dalloja që isha vëllai i Shefqetit. Deri sa një ditë, ishim në krah të njëri - tjetrit me fotografitë tona në Këndin e Emulacionit të Shkollës, saktësisht në stendën “Oficerë dhe kursantë të dalluar”.

Dola kaq shumë nga modestia ime, sepse desha të mbërrija në një “pakënaqësi” timen ndaj tij. Kur gjithë shokët e mij, në gjashtëmujorin e parë, kishin shkuar pranë familjeve deri edhe dy herë, paçka rezultateve që kishin arritur, mua të dalluarit, Shefqeti, ma kishte refuzuar disa herë kërkesën për të shkuar dhe u takuar me prindërit dhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Madje, kujtoj se në një rast, ai e kishte grisur “Fletë lejën” shtatëditore që më kishte plotësuar komandanti i baterisë. Derisa një ditë, vendosa t'i trokasë në zyrë, shefit të Shtabit të Komandës së Shkollës, zemërbardhit Hysen Shehu, për t'u “ankuar” për Shefqetin dhe lutur të respektohet e drejta ime, si gjithë të tjerët. Mbaj mend si tani që më ka mbushur në moment, një “Fletë lejë” dhjetëditore dhe më ka dhënë “urdhër ushtarak” për t'u nisur atë ditë drejt Korçës. Pjesë e urdhërit ushtarak, ishte edhe këshilla “Mos e tako as Shefqetin!”... Ika, u çmalla me familjen dhe u ktheva për të përjetuar gjatë qefmbetjen e Shefqetit, duke mos më takuar për disa javë si ndëshkim i ikjes “pa lejë”... Ky ishte im vëlla - Shefqeti!

BUSULLA E DREJTIMIT NË UDHËN E MIRËSISË DHE TË DINJITETIT

Natyrë strikte dhe individualiteti i jashtëzakonshëm, e kishte pajtuar përjetësisht me korrektësinë, ndershmërinë, pastërtinë dhe drejtësinë. Shefqeti nuk pati shumë miq, ose thënë ndryshe me listë, por ata që kishte, të vjetër dhe të rinj, nuk iu larguan deri në fund të jetës së tij. Ai ishte për rrethin e ngushtë miqësor, busulla e drejtimit në udhën e mirësisë dhe të dinjitetit, ai ishte për ata, i pari konsulent i pagabueshëm në përballimin e çdo shtetë dhe udhëkryqi, ai ishte i pari që do të trokiste në dyert e tyre, për të uruar një gëzim apo ndarë një shqetësim të tyre. Ai edhe në këto vite të demokracisë, jetoi “jashtë mode”, duke mos ua harruar shtëpinë në të mirë dhe në të keqe, ashtu si “...e do zakoni dhe meriton Mikul”.

I tillë ishte Shefqeti edhe për ne! Me dashurinë dhe përgjegjshmërinë e vëllait të madh, ai u pozicionua në rolin e Babit, për kujdesje dhe mbështetje duke na ideuar dhe orientuar në udhën e dijes dhe të përparimit të kohës. Shtëpia dhe familja e tij u bënë streha e parë për gjithë ne të tjerët, pasi u shkëputëm nga vendlindja. Deri sa ne çelëm familjet tona për asnjë çast nuk na ka munguar dhëmbshuria dhe ndihma e tij e gjithanshme. Dhe më shumë se kaq, ishte më i miri udhërrëfyes dhe frymëzues për të qenë të respektuar dhe të nderuar në çdo hap të jetës dhe mbi të gjitha dinjitozë në familjet tona.

Me pak fjalë, Shefqeti, ishte modeli i përkryer njerëzor! I edukuar dhe me kulturë intelektuale, në çdo detaj të përditshmërisë së vet; pasionant dhe i përkushtuar në pedagogjinë dhe praktikën xhenjore; korrekt dhe i disiplinuar në marrëdhëniet njerëzore me miq dhe shokë; i papërtuar dhe i pakursyer për të ndihmuar të afërmit dhe ata që kishin nevojë për angazhimin e tij, i dhimbshur dhe i ndjeshëm në çdo moment ndaj bashkëshortes dhe dy djemve.

Iku pa lajmëruar, pa u ndjerë! Ashtu si u shfaq në 83 vite jetë, duke mos dashur të binte në sy. Një jetë e përmbushur më së miri, me sukses dhe dinjitet njerëzor që na bën krenar dhe na largon mungesën e tij.

Do desha shumë t'i ngajja tim vëllai, për mua më shumë se vëlla - Shefqeti!



Vëllazërit Sejamini me motrat dhe nënën

DOSSIER

FILLIMI I FUNDIT TË GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË

Nga Bashkim Hisari

Më 24 mars, u mbushën 21 vjet prej fillimit të sulmeve ajrore të Aleancës Veri Atlantike ndaj caqeve serbe – jugosllave, me të cilat filloi edhe një epoka e re për Kosovën dhe qytetarët e sajë.

Një ditë para fillimit të bombardimeve, edhe pse ishte ditë tregu, qytetin e Prizrenit kishte kapluar heshtja. Rrugët ishin të zbrazura, shitoret prej sheshit Shatërvani deri në Bazhdaranë të plaçkitura. Nuk dëgjoheshin të shtënat e armëve të rënda, topave, minahedhësve, mortajave dhe rafalet e mitrolezëve që zakonisht vinin nga zona e kufirit me Shqipërinë, Vërrini dhe mali Pashtrik. Pak banorë që nuk ishin nxjerë nga shtëpitë e tyre, ishin të pambrojtur, të mbyllur në podrume dhe në shënjestër të ushtarëve jugosllavë, policët dhe paraushtarakët serb që sulmonin me tanke dhe arteleri. Banorët nuk guxonin të dilnin në oborre dhe nuk dinin se çfarë do të sjellë nesërmja. Forcat serbe bënë vrasje të paramenduara dhe ushtronin formë të tjera të dhunës si armë lufte apo instrument për spastrim etnik. Dëbimet e dhunshme, arrestimet e paraburgimet vazhdonin dhe ato ishin diçka e zakonshme. Shumë shpesh burrat ndaheshin nga grate dhe mbaheshin në burgim të improvizuar. Të gjitha këto shoqëroreshin edhe me grabitje e plaçkitje dhe përpjekje për të shkatërruar UÇK-në dhe bazat e saj të mbështetjes.

Para fillimit të bombardimeve, në qytetin e Prizrenit ndodhën disa krime më barbara. Në kohën e iftarit të Ramazanit brenda dyqanit të tyre "Mega-Sport" në qendër të qytetit u ekzekutuan, Bujar dhe Edmond Godenin. Trupat e masakruara të dy të rinjëve tjerë, Suliman Rrotlla dhe Petrit Bytyqi, u gjetën në fshatin Gjinovc afër Suharekës. Para shtëpisë së tij kidnapuan dhe pastaj masakruan edhe djaloshin Ardian Zurnaxhiu. Dhunshëm u dëbuan shumë intelektualë. Mijra civilë u larguan nga shtëpitë e tyre dhe u dërgjuan Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe në vendet tjera për të shpëtuar jetën.

Konfliktet në Kosovë dhe krimet serbe ndaj shqiptarëve, ishin bërë problem botëror dhe të gjitha mediat u kushtonin vëmendje të veçantë. Kur 24 mars diku rreth orës 20:00, u lajmërua se avionët e NATO-s kishin filluar bombardimet e caqeve ushtarake të Jugosllavisë dhe se bombat e raketat kishin filluar të binin në kazermat ushtarake, aeroporte, qytete e fshatra, në objekte publike... u rrit optimizmi i qytetarëve për shpëtimin nga krimet serbe. Shpresat e tyre se do të dilnin nga situata e tmerrshme dhe të fitonin lirinë, ishin drejtuar kah SHBA dhe NATO ndaj të cilëve tregonin plotë nderim e respekt.

Mirëpo, me fillimin e intervenimit të NATO-s, forcat paramilitare serbe të mbështetura nga pushteti serb të dislokuar gjithëandej Kosovës. me brutalitetin e paparë nisën ofanzivën e hakmarrjes ndaj mijëra njerëzve të pafajshëm dhe të pambrojtur. U krijua anarki e përgjithshme që u mundësoi



kriminelëve e banditëve të vazhdonin me krimet e tyre. Qeveria serbe nuk bëri asgjë për t'i frenuar këta njerëz. Përkundrazi, paraushtarakët që kishin përvojë nga lufta në Bosnje dhe Kroaci u dërguan në Kosovë. Madje, disa kriminelë u liruan nga burgu, pasi ata kishin rënë dakord të luftonin në Kosovë. Egërsisht kryenin masakra mbi popullsinë civile. Nuk kursente askend dhe asgjë në Kosovë. Ekzekutuan mijëra shqiptarë në gjithë Kosovën. U vranë së bashku fëmijë e vegjël, gra e burra, shkatërruan dhe u plaçkitën pronat.

Në Kosovë janë vranë dhe masakruar më shumë se 13.500 shqiptarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftime, prej tyre 1.393 fëmijë, 1.379 gra. Mbi 1.600 persona ende janë të pagjetur. Fshatrat Landovicë, Krushë e Vogël, Krushë e Madhe, Celinë, Fortesë si dhe Rahovec që ndodhen në rajonin e rrugës magjistrale Prizren-Gjakovë, dhe qyteti i Suharekës me rrethinë ishin më të parat që u goditën nga trupat qeveritare serbe dhe jugosllave menjëherë pas fillimit të fushatës së NATO-s më 24 mars 1999.

Pasojat e aktiviteteve kriminale serbe të asaj dite ishin të tmerrshme për fshatëtarët e Fortesës ish Bellacerkë. Atë ditë, në Fortesë, forcat serbe kanë vranë dhe masakruar 65 civilë shqiptarë duke mos kursyer as fëmijët. Prej tyre, 26 antarë të familjes Zhuniqi dhe 20 të familjes Popaj. Viktima më e re ishte Labiot Spahiu, vetëm 3 vjeç, kurse më i vjetër, Xhemajli Spahiu 80 vjeç. Në mesin e të vranëve ishin edhe 7 fëmijë të moshës nën 10 vjeç dhe 2 invalidë. Prej 350 shtëpive sa kishte fshati Fortesë, vetëm 12 nuk ishin djegur plotësisht. Po të njëjtën kohë edhe në fshatin e afërt Celinë, forcat serbe kanë vranë dhe masakruar 86 martirë në sytë e Valon Zeqirit 13 vjeçar nxëns në shkollën fillore të këtij fshati.

Po atë ditë, masakrat monstruese në Krushë e Madhe përfunduan me 241 të vranë, të masakruar dhe të zhdukur. Prej tyre, 142 burra, gra, fëmijë dhe pleq krushjanë, tani pushojnë në varrezat e fshatit, nga të cilët, 35 të vranë ishin mysafirë që erdhën nga vendbanime të tjera. Kufomat e shumicës prej tyre u gjetën në dy krematorijume dhe në tetë varreza masive në këtë fshat. Për fatin e 64 personave nuk dihet asgjë dhe

ata, ende janë të pagjetur. I mbijetuari i masakrës në Krushë e Madhe bujku Sulejman Gashi tregoi se janë bërë edhe dëma të mëdha në ekonomi. „Kemi evidentuar se janë vranë 630 lopë, 200 viç, 180 dema, 550 dele, 245 qengja etj. Janë shkatërruar 175 traktorë, 157 rimorkio, 152 multikultivatorë, 123 kamionë, 175 vetura dhe makina të tjera bujqësore. Janë grabitur 1784 televizorë, 294 video regjistruar, 932 fshesa elektrike, 578 frigoriferë dhe paisje tjera“.

SULEJMAN GASHI: "NA FIKËN, NA SHKATËRRUAN KREJT ÇFAR KEMI PASUR".



21 vjetë më parë, në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, edhe banorët shqiptarë të fshatit, Krushë e Vogël të komunës së Prizrenit përjetuan tmerrin e paparë të akteve të dhunës. Atë ditë të kobëshme në fillim të pranverës, forcat militare dhe paramilitare serbe, në formë më mizore dhe më brutale, duke gjuajtur me tanksa, topa e minahedhës, granatuan fshatin dhe vranë, ekzekutuan, masakruan dhe kallën kufomat e 114 burrave dhe fëmijëve. Viktimat ishin civilë shqiptarë të moshës 13 deri në 77 vjeç. Shumë familje mbetën pa asnjë mashkull në shtëpi. 150 fëmijë mbetën pa prindë kurse 82 gra pa burra. U plaçkitën dhe u dogjën 137 prej 145 objekteve, fshati u rrafshua me tokën.

Më 25 mars të vitit 1999, herët në mëngjes, forcat serbe së bashku me policët lokal, kishin rrethuar qytetin e Suharekës dhe pastaj kishin zhvilluar një aksion kundër civilëve shqiptarë. Kishin shkuar shtëpi në shtëpi, dhe me tytën e pushkëve kanë kërcënuar: "Keni 15 minuta për t'u larguar për në Shqipëri dhe kurrë nuk do ta shihni më

këtë tokë". Krimi më i madhë dhe më i tmerrshëm është bërë ndaj familjes Berisha. Një grup kryesisht me gra e fëmi, serbët i kishin dërguar në picerinë "Kallabria" në qendër të Suharekës ku kanë kryer krim gjenocidi duke vranë me armë zjarri dhe duke gjuajtur me bomba për t'u siguruar se askush s'do të mbijetojë, vranë 49 anëtarë të kësaj familje. Mbijetuan tre anëtarë të familjes Berisha, Vjollca, biri i saj 9 vjeçar Gramozi dhe Shyhretja.

VJOLLCA BERISHA: "NË KËTË OBJEKT MASAKRUAN 49 ANTARË TË FAMILJES BEISHA. MBIJETUAN VETËN VJOLLCA, BIRI I SAJ GRAMOZI DHE SHYHRETE BERISHA, GJATË TRANSPORTIT TË VIKTIMAVE DREJT PRIZRENIT, ATA TË PLAGOSUR KËRCYEN NGA KAMIONI QË ISHTE NË LËVIZJE DHE SHPËTUAN".



Në kohën kur rajoni i Prizrenit po përjetonte terror nga forcat serbe, të cilat ishin egërsuar edhe më shumë pas fillimit të intervenimit ushtarak të NATO-s, kriminelët serbë kryen aktin e qëllimshëm e makabër ndaj trashëgimisë sonë. Dogjën dhe plotësisht e shkatërruan Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Këtë akt barbar e bënë qëllimisht për të frikësuar popullatën, për të dëbuar edhe ata pak qytetarë të mbetur nga shtëpitë e tyre dhe për të zhdukur dokumentacionin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, njëres nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar.

Përtej çdo dushimi të arsyeshme është qartë se forcat qeveritare dhe paramilitare serbe kanë kryer edhe krime tjera të tmerrshme. Ekzekutuan qindra burra civilë, masakruan fëmijë, gra e pleq, zhvendosën kufomat, dogjën dhe shkatërruan pronën private e fetare, dhunshëm dëbuan, arrestuan, grabitën dhe plaçkitën banorët shqiptarë. Fatkëqësisht, edhe pas 21 viteve prej fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë, në mbrojtje të Kosovës, autorët e këtyre krimeve nuk janë ndëshkuar ndonëse ekzistojnë dokumentet dhe dëshmitë e viktimave.

Fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë, në mbrojtje të Kosovës, autorët e këtyre krimeve nuk janë ndëshkuar ndonëse ekzistojnë dokumentet dhe dëshmitë e viktimave.

EDITORIALI

Emblemë e qëndresës dhe e disidencës

Halil RAMA

(vijon nga fq.1)

Do të mjaftonte qoftë dhe vetëm ky shënim në librin e ngushëllimeve, i dy personaliteteve të letrave dhe politikës, Arta Dade e Namik Dokle për të profilizuar gjeneralin legjendë në kufirin e tri kohëve. Por në qindra mesazhet e ngushëllimeve për gjeneralin që “u fik në paqe dhe iku në këmbë” (siç shprehet gjeneral Piro Ahmetaj), kupton fare lehtë se Ai iku duke i lënë Familjes, bashkëluftëtarëve e bashkëpunëtorëve, shokëve e miqve në gjithë hapësirën mbarëshqiptare të vetmin testament, atë të atdhedashurisë... Gjeneral Parllaku ishte ndër të paktët partizanë që jetoji dhe dëshmoi histori të tri kohëve, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist.

Ai ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe sot është gjenerali më i vjetër, por me mendje të re që mbështeti anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO.

Vetëm para një viti, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”. Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë Ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike.

Shqiptarët ndjehen krenarë me jetën dhe veprën e Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit që bëri gjithshka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.

Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtytit familjar të trashëguar ndër shekuj.

Opinion publik ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga gjenerali, siç është ai me titull: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova, ëndrra e jetës sime”, dhe librin e fundit të tij me shtatë kapituj në 466 faqe “Një shekull në memorie”.

Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, gjeneral Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. E veçanta e gjithë “ligjëratave” të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacionalçlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konciz, realist, pa mllëfe, pa paragjykime... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit të tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë...si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.



NGA JETA E KËTIJ MATUZALEMI NA ULET KËMBËKRYQ HISTORIA

Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këtë çerek shekull të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Në spiralet e historisë, Gjeneral Parllaku ka ditur të lakohet me dinjitet duke patur si kolonë bazë përkushtimin kombëtar shqiptar dhe progresin shoqëror, si thelb i motivimit që gëlonte shpirtin e tij progresist e liridashës. Vështirë të përmbledhësh në pak radhë, në kuinesencë, motivimin e personalitetit të tij, zhvillimin konjitiv e psikomotor të këtij djaloshi që ngjitej nga Novosej i Kukësit në Tribuna të larta shtetërore, në hero të popullit të tij, në drejtues madhor ushtarak, duke ndryshuar variablat në kontekste politike në funksion të mbijetesës dhe qëndresës, nga udhëheqës i shquar në të dënuar me burg, nga triumfator në grigjë të rrezikut për jetën, nga piedestali i kuadrit të dobishëm në stigmën e “njeriut të rrezikshëm”, ekstreme këto që provokuan në personalitetin e Tij, qëndrime dhe vlera të larta politiko-shoqërore në raportin e ndjenjave të forta estetike midis dashurisë dhe urrejtjes. Këtë volum ideor dhe estetik e përcjell përgjatë shekullit të jetës së tij, një burrë shtetar, një organizëm vital, një mendje koherente dhe një vizion largpamës dhe perspektiv.

HEROI QË FITOI DUKE MERITUAR LAVDINË DHE PAVDEKËSINË




Retrospektiva dhe perspektiva kanë një prerje të artë në personalitetin e Gjeneral Parllakut, atë e përshkon frymëzimi dhe dashuria për Atdheun e tij,

si leitmotiv vijues mbikohor që çliron në rrethana tipike energji shpirtërore pozitive në luftën e jetës. Jeta e Tij është një shembëlltyrë e rrallë që na fton të kuptojmë se jeta meriton të jetohej kur luftohet fort dhe fitohet. Si një ushtarak, korrekt, i shquar ai mbështetej në skrupuj të fortë të moralit kombëtar, me pikëvështrim të qartë dhe të kthjellët, duke ngjitur një nga një shkallët e karrierës ushtarake, si një gjigand hijerëndë që ngjitet i sigurtë në bedenat e kalasë. Kalaja e pushteteve në kohë të ndryshme dhe situatë të ndryshme pati dhe shembje morale e politike, por këto nuk e dobësuan dhe përulën Gjeneral Rrahman Parllakun, këtë soj të fortë shqiptari që me mençuri diti të manovrojë në spiralet e rrezikshme të historisë shqiptare.

Heroi i luftës në terren, i luftës dhe përballjes në gjyqje ushtarake, përballoi burgje e privime dhe fitoi duke merituar lavdinë dhe pavdekësinë. Jeta iu afrua Heroit herë me tufa me lule herë duke u derdhur mbi të me tërë egërsinë e saj. Rrallë gjen shembuj të tillë të personalitetit ku të jenë ngjizur e plazmuar në mënyrë aq mjeshtërore vetitë e karakterit të një intelektual patriot, të një drejtuesi e komanduesi të aftë ushtarak, të zgjuar dhe trim, të thjeshtë dhe të ndershëm, të bukur në trup, shpirt dhe mendime.

Ai është një model i ardhur nga genocidi komunist si dëshmitar i gjallë për të kuptuar dhe vërtetuar peripecitë dhe traumat që kaloi ky popull i orientuar dhe i ideologjizuar gabimisht nga rryma dhe korrente të huaja.

Mbi 20 vjet në krye të Shoqatës së Veteranëve të Luftës, me ndershmëri dhe principe të larta morale ka kontribuar në ndriçimin e mjaft skenave dhe protagonistëve, të vërtetave dhe kërkimeve historike duke dhënë edhe



në moshë pensioni, një ndihmesë të vyer në emancipimin politiko-shoqëror e demokratik të shoqërisë. Si një lundëtar i shquar ai e drejtoi varkën e shpëtimit duke kapërcyer me sukses tallazet e historisë deri në brigjet e paqëta të demokracisë që po jetojmë.

Jo vetëm gjatësia kohore e jetës por dendësia dhe përmbushja e saj me veprime, qëndrime dhe vlera në përmbajtjen e saj, e bënë këtë figurë të lartësohet në nderimin tonë shoqëror, ku zëri dhe mesazhet e Tij dëgjohen deri në organizata famoze ndërkombëtare. Në këtë vështrim Gjeneral Rrahman Parllaku përbën një shembull frymëzimi për atdhedashurinë dhe përkushtimin qytetar.

LIBRI

Disa gra të shquara nga Bulqiza në librin me 805 faqe të poetit e publicistit Kujtim Boriçi



ENGJELL MUSAI

Drejtor i gazetës "Telegraf"

Ka kaluar një vit që nga publikimi i pjesë së parë të librit "Oficeret shqiptare në rrjedhën e historisë", i autorëve Suzana Jahollari e Kujtim Boriçi, e tashëm na vjen në duar pjesa e dytë e tij. Si një nga miqtë e kolegët e afërt të autorëve, më vjen mirë të konfirmoj se kjo periudhë, vërtetoi plotësisht atë që unë pohova në hyrje të vëllimit të parë për lexuesin se: "... Dua të pohoj se ky libër krejt i veçantë në publicistikën historike të 20 viteve të fundit, është para së gjithash një punim serioz publicistik dhe historik i munguar deri tani. Nëpërmjet dokumenteve të arkivave në kohë

të ndryshme, në Shqipëri e jashtë saj, nëpërmjet portreteve, dëshmime e ngjarjeve mbi rolin e grave ushtarake ndër shekuj, në pjesën e parë të këtij libri, sillet një pjesë e historisë së qëndresës së popullit tonë përballë invazioneve, veçanërisht për rolin e pazëvendësueshëm të grave shqiptare...!". Në mos gaboj, për këtë libër (pjesën e parë), gjatë një viti, është shkruar më shumë se për këdo libër tjetër të këtij lloji në gazetë qendrore të kohës, nga studiues e lexues të thjeshtë. Dhe të gjithë, e kanë vlerësuar këtë libër si një arritje në publicistikë dhe si një libër me vlera dokumentare dhe historike për rolin e grave tribune e me uniformë në dekada e shekuj, brenda e jashtë kufijve aktualë të Shqipërisë. Dhe ja, tani vjen pjesa e dytë e tij, në të njëjtën linjë, shton vlera të tjera në këtë kolanë interesante. Njëkohësisht, rikonfirmoj se kam kënaqësinë dhe nderin të promovoj



këtë libër në gazetë për një lexues më të gjerë. Urime dhe suksese në

vazhdim autorëve Suzana Jahollari e Kujtim Boriçi!

PROFILI

Oficerja e re, Klenisa Xheka nga Bulqiza: Uniforma më bëri të përjetoj emocione të veçanta

Quhem Klenisa Xheka, e lindur më 27 prill të vitit 1997, në qytetin e vogël të Bulqizës. Kam mbaruar studimet e larta në degën Shkenca Politike & Marrëdhënie Ndërkombëtare në Tiranë. Duke lënë pas ëndrrën time për gazetarinë, mbylla me rezultate tepër të mira ciklin 3-vjeçar. Që e vogël, kam ndjekur botën e medias, duke nisur me recitime në vitin 2005, duke vijuar me pas si moderatore e lajmeve në konkurse të ndryshme pranë qytetit tim. Në asnjë moment të jetës, nuk e kisha menduar veten pjesëtare të uniformës.

E në fakt, mbaj mend para se daja im të ndërronte jetë si një oficer i denjë e i përkushtuar, pas punës, uniformës i kushtonte rëndësi të veçantë, pasi për të, uniforma ishte detaji që e bënte një ushtarak të ishte vigjilent. Pavarësisht këtij detaji, pyetjet e mia i kisha gjithmonë të kursyera rreth uniformës, pasi mendoja që privatësia ushtarake, nuk duhej cenuar. Nuk e di si ndodhi, por diçka brenda vetes, më thoshte që unë duhej të aplikoj në atë kurs.

Ne fakt, ashtu ndodhi. Konkursi, u përzgjodha dhe fjalët motivuese të familjarëve të mi, ishin shtysa e vetme që më bënë mua të besoj që gjithçka që e dëshirojmë fort, e arrijmë. Ishin këto fjalët që mora me vete, pikërisht në datën 15



tetor 2018, ku jeta ime mori një rrjedhë krejtësisht tjetër. Nisi kursi 9-mujor, ku 3-mujat e parë, u zhvilluan në Bunavi të Vlorës me in-

strukturë e oficerë përkatës. Ishte një nisme krejt e panjohur për mua, e vështirë, por që në vetvete mbarte një lloj bukurie të veçante.

Brenda vetes, me thoshte diçka që këtë nismë, duhet ta duash e pastaj ta arrish.

Ndihesha ndryshe nga të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, të qenurit pjesë e uniformës, bënte diferencën për mua.

Më pas, në janar të vitit 2019, kur si nisi në Zall-Herr, për gati 6-mujat. Ishin ditët e një rutine të njëjtë, derisa pak nga pak, ditët po pasonin kohën njëra-tjetrës, me padurim, prisja ditën e diplomimit. 19 korriku, ishte dita që më bëri të përjetoj emocionet unike të të mbajturit mbi supë gradën time të parë, ndjesinë e të qenurit pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Pas përfundimit me sukses të kursit 9-mujor me datë 01.08.2019, mora emërimin e parë pranë batalionit të dytë të këmbësorisë (B2K), në një kompani mbështetëse logjistike, me detyrë komandante e togës së mbështetjes.

Disa javë më pas, ndoqa kursin bazë të oficerit me specializim logjistikën, në degën furnizim. Dalëngadalë, tashmë unë isha bërë pjesë e familjes së madhe të Forcave të Armatosura, shërbej për atdheun tim. Uniforma më bëri të përjetoj emocione të veçanta unike, duke më dhënë vlera, nder dhe krenari, si një oficer e denjë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

TAKIMI

Lufta e Dytë Botërore dhe lufta e UÇK-së, ngjarjet më të ndritura në historinë e kombit shqiptar

Organizata e veteranëve të LANÇ të Kosovës, film dokumentar për Fadil Hoxhën

Nga Bashkim Hisari

Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini priti një delegacion të Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës (LANÇ), udhëhequr nga kryetari Zija

Mulhaxha. Në këtë takim, kryetari Gjini tha se duhet të respektohen, nderohen dhe t'u jepet vend i merituar të gjithë atyre që kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ai nënvizoi përkushtimin e komunës së Gjakovës për jetësimin e vendimit për rikonstruimin e Eshtnoves së dëshmorëve të rënë të LANÇ që ndodhet në Çabrat e cila me vendimin e Asamblesë komunale tani e mbanë emrin e heroit të popullit Fadil Hoxha. Kryetari i komunës së Gjakovës tha se për kompletimin e këtij objekti komuna ka ndarë 80 mijë euro dhe se kompleksi memorial do jetë funksional deri në shtator të këtij viti.

Ndërkohë veteranët të LANÇ të Kosovës dhe pasardhësit e tyre shprehën gatishmërinë për një bashkëpunim më intensiv në realizimin e synimeve të përbashkëta për t'i kontribuar avancimit të komunës

së Gjakovës në të gjitha fusha dhe për zhvillimin, stabilitetin dhe prosperitetin e Republikës së Kosovës. Me këtë rast ata, nënvizuan se Lufta e Dytë Botërore dhe lufta e UÇK-s ishin ngjarjet më të ndritura në historinë e kombit shqiptar. Kryetarin Gjini, ata e informuan për aktivitetet që do të zhvillojnë për shënimin e 75-vjetorit të fitores ndaj nazifashizmit duke u shprehur se kjo fitore do të shënohet në mënyrë madhsh-tore, dinjitoze dhe me respektin më të thellë do të përkujtohen të gjithë ata djemë e vajza që deshën kombin, atdheun dhe lirinë e vendit. Në përkujtim të atyre që na sollën lirinë, do të vendosen buqeta lulesh në varrezat e tyre dhe do të organizohet Akademi përkujtimore. Veteranët e LANÇ dhe pasardhësit e tyre bashkë me veteranët nga Shqipëria do të vizitojnë Bujanin, vëndin ku është mbajtur Konferenca e cila bëri të gjithë bashkë për parimin e vetëvendosjes dhe bashkimin kombëtar dhe do të organizojnë aktivitete të tjera. Në kuadër të shënimit të 75 vjetorit fitores kundër nazifashizmit, epopesë më të lavdishme të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, do të promovohet edhe filmi dokumentar "Një jetë në shë-



bim të atdheut" kushtuar jetës dhe veprës së heroit të popullit Fadil Hoxha. Filmi dokumentar për Fadil Hoxhën, njërit prej figurave më të shquar në historinë moderne të Kosovës që i dha vendit dinjitetin e qendresës, mbijetesës, sfidën dhe luftën e përgjakshme për liri e pavarësi kombëtare do të shfaqet në Tiranë, Prishtinë dhe Gjakovë.

Me librin në këto kohë të trishta

- *Në këto kohë vetëzolim në shtëpitë tona, nund dhe duhet t'i përkushtohemi edhe historisë së popullit tonë, e në këtë kontekst do të mjaftonim të lexonim tri librat që na la amanet Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku: "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre", "Kosova e lirë ëndrra e jetës sime" dhe "Një shekull në memorie". Në këto vepra është historia e Luftës së lavdishme Antifashiste nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, luftë kjo që e renditi Shqipërinë përkrah Aleancës së madhe të popujve të kryesuar nga Britania e Madhe, SHBA dhe ish Bashkimi Sovjetik*

Nga Halil RAMA

I VETËKARANTINUAR KUNDËR COVID-19, ME "DJALLI KOMIK", "PESE DITË NË PARIS" dhe "DASHURI NË KOHËN E KOLERËS"...

Tre romane, me të cilët mund të humbasësh në botën e brendshme të personazheve të tyre dhe të hedhësh tej për disa caste ankthit që na ka shkaktuar kjo kolerë e kohëve moderne... Fillimisht me "DJALLI KOMIK", një nga kryeveprat e të madhit Zija Çela kupton profecinë e tij, kur sëmundja misterioze e ngrirjes mori qindra jetë njerëzish në qytetin e Horketës... Ngjarje dhe personazhe të skalitura mjeshtërisht nga shumë i dashtuni Zija, në koherencë me këtë realitet të trishtë. Do të mjaftonte për ta kuptuar këtë goftë edhe vetëm ky perifraxim nga ky roman mbresëlënës: "Në tri javë sëmundja e ngrirjes asnjë ditë nuk u ndal. Ndryshe nga fillimi, ato shenjat e katastrofës tani përveçse ndiheshin, dukeshin edhe me sy..." (fq.31). Apo edhe kur: "...zoti Mentor Tanashi, i zgjedhur kryetar bashkie pas Lumbardit, e modifikoi qarkullimin, duke hartuar një rregullore të veçantë për këmbësorët" (fq.33). Më tej në fq.63: "...Sara, gruaja e kryebashkiakut ia citoi si rastësisht gruas së Tanashit këtë ankim të Glosterit: 'S'e di. Po bota u bë kaq e keqe, sa zoçkat hanë ku s'guxojnë shqiptet. Që kur çdo horr u bë këtu fisnik, shumë fisnikë janë bërë horra...".

Dhe mund të vazhdojmë kështu me perifraxime nga "25 Danielët" e këtij romani kryevepër, ku mjeshtri i prozës shqipe Zija Çela na mahnit me peshën e bukurinë e fjalës dhe me mendimin e thellë filozofik, që sipas Mehmet Krajës, përçohet aq bukur në rrëfime të zhdërvjellët, alegorik, meditativ, me depërtime gjuhësore në shtresime kuptimore të panjohura dhe të paprovuara në prozën tonë... Koherencë me këtë realitet gjejmë edhe në romanin "Pesë ditë në Paris" të Daniel Still, ku personazhi kryesor, Peteri, nuk pranoi kurrësesi t'ua servite të famshmin "Vikotek", të sëmurëve me kancer, pa u bindur më parë në dobinë e tij. Një tjetër roman i rekomanduar për këto kohë tragjike është padyshim



"Dashuri në kohën e kolerës" i Gabriel Garcia Marquez, nga fundi i të cilit është "era e tharëve njerëzore, të cilën ai e kishte zbuluar te dashnoret e tij më të moshuara – dhe ato tek ai"....

Libri është padyshim ushqimi më i mirë shpërtëror në këto kohë të trishta. Përzgjedhja e tij si shoku e mikut më i mirë në vetëzolim është padyshim në dorën e lexuesit, mjafton vullneti i tij i mirë. Unë rekomandova tre romane që më patën mbetur ende pa u lexuar nga korpusi i librave në raftet e bibliotekës sime familjare....


Por, nga Zija Çela, për shembull, mund të lexojmë e të mrekullohem edhe me romanin e tij të fundit "Lavjerrësi i qytetit" që kapërcen barrierat letrare, dhe i vendos ngjarjet gjithkund, pse jo, në mes të Tiranës kryeqytet. Me një rrëfim që të rrëmben ujërave të një filo-

zofie mbresëlënëse, shkrimtari bën bashkë të ndershmë e të pandershmë, të lirë e të burgosur, duke bërë që çdo bindje rreth ndërgjegjes njerëzore të lëkundet. E drejta edhe e padrejta, vihen pranë, kundër lëkundën në trampolinë e rrethanave, duke na bërë të mendojmë se asgjë nuk është e sigurtë.

Në këto kohë vetëzolim në shtëpitë tona, nund dhe duhet t'i përkushtohemi edhe historisë së popullit tonë, e në këtë kontekst do të mjaftonim të lexonim tri librat që na la amanet Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku: "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre", "Kosova e lirë ëndrra e jetës sime" dhe "Një shekull në memorie". Në këto vepra është historia e Luftës së lavdishme Antifashiste nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, luftë kjo që e renditi Shqipërinë përkrah Aleancës së madhe të popujve të kryesuar nga Britania e Madhe, SHBA dhe ish Bashkimi Sovjetik.

Ndërsa nga Teodor Laço i cili, në korpusin e tij letrar, përfshin më se 50 tituj romanesh, vëllimesh me tregime, dramash, komedish e kujtimesh, do ia vlente të lexonim goftë dhe dy vëllimet e tij: "Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar" dhe "Bashkëjetesë me kohën" (Shënime politike, letrare intime). Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, eseist, komentator, opinionist e politolog, Laço padyshim njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe ai i huaj ku është përkthyer, si një nga kolosët e letrave shqipe. Dhe nëse, në këto gjini, Laço radhitet me elitën krijuese të kombit, ai si poet njihet pak. Jo se nuk ka shkruar poezi, por ato i ka ruajtur si "thesare" të laboratorit të tij krijues nga i cili poeti Bardhyl Londo përzgjedhi me botoi vëllimin poetic të Laços me titullin sinjifikativ "Hapjani dritaren pulëbardhës". Në këtë linjë mund të rendisim edhe poetin e prozatorin e mirënjohur Shefki Karadaku, i cili para disa kohësh u botua edhe në gjuhën gjermane. Revista letrare gjermane "Literatura Nr. 11, ndërmjet 20 autorëve nga Gjermania dhe vendet e tjera të Europës dhe Ballkanit, boton edhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarit shqiptar, Shefki Karadaku. Revista është botuar nga shoqëria letrare Marburg e Universitetit të Marburgut. Kopjet e saj ruhen në bibliotekën gjermane sipas ISSN.

Kohët e fundit u ribotua vëllimi me novela "Arkadia e largët", i shkrimtarit Shefki Karadaku. Këto novela sirtari te viteve 1975-1978 nuk e njohën dritën e botimit kur u krijuan, para viteve '90, por vetëm tani. Janë botuar në vitin 1994 dhe janë ribotuar në vitin 2012 për vetë trajtesën e tyre dhe stilin e tyre të veçantë letrar. Teksa lexon këtë vëllim shumë tërheqës, vetëtimthi të kujtohet krijimtaria letrare e këtij poeti dhe prozatori që shkruan prej pesë dekadash, si romanet "Një mijë vjet dashuri", "Argonautët", "Vila e magjepsur", "Salaman-drat", "Filantropi", "Panegjërësi", "Gjergj Elez Alia", "Sagë mbretërore" si dhe disa novela e vëllime me poezi. Mund të vazhdonim kështu me dhjetra e qindra pena të spikatura, pasi fatmirësisht nga e drejta për të lexuar nuk jemi privuar edhe në këto ditë kur po përjetojmë pasojat e kësaj kolere të kohëve moderne.



URIMI

Lajm shumë i mirë:

“MAQEDONIA E VERIUT, “de Jure” anëtare e 30 e NATO-s”!

E kam përjetuar me shumë kënaqësi lajmin e shpërndarë nga Sekretari Përgjithshëm, Jans Stotenberg, i cili konfirmon se, me votën e Spanjës, konfirmohet “de Jure” anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut (MV) në NATO!

“Procedura burokratike” do të ndjek administrimin e “Protokolit” të nënshkruar nga 29 vendet në Washington DC, dhe kjo do të shënojë edhe datën zyrtare të anëtarësimit me të drejta të plota të MV në NATO. Në vijim po ndaj disa vlerësime dhe mesazhe strategjike, për këtë ngjarje:

1. Arritje e vonuar por e merituar, historike, jetike dhe gjeo-strategjike për MV.
2. Kështu, është jo vetëm një lajm i mirë por një ngjarje e një rëndësie strategjike për Rajonin si dhe vlerë e shtuar për NATO-n!
3. Inkurajim për të “izoluar” zgjerimin e influencës së Rusisë dhe Kinës në Ballkan.



Gjeneral Piro Ahmetaj uron mirëseardhjen e Maqedonisë së Veriut në NATO



4. Politika e mençur e NATO-s, dhe e SHBA: “më mire “in/brenda se out/jashte”, mbetet si shëmbull-shprese edhe për anëtarësimin e 2 vendeve tona në BE.
5. Siguria dhe stabiliteti demokratik në rajonin tonë mbetet ende e brishtë. Sfidat janë të përbashkëta, si: terrorizmi, oligarkitë politike, krizat ekonomike, kërcënimet elektronike, krimi i organizuar, emergjencat mjekësore, etj.
6. Nga kërcënimet & sfidat mundet & duhet të eksplorojmë oportunitete pozitive, për të mbjellë “paqe të qëndrueshme”, për vete,

fëmijët tanë dhe brezat që vijnë.
7. Mundësi gjeostrategjike & ekonomike, që të jetësohet një projekt i përbashkët midis RSH, MV, RK dhe MZ, si për: “policimin ajror, mbrojtjen kibernetike, sistemin arsimor & stërvitjen,

emegjencat civile, etj”.

uroj për zemërsisht mirëseardhjen MV në familjen e vlerave & sfidave të përbashkëta.

*** Gjeneral (r) Piro Ametaj, Këshilltar për SK në PD; ish-Përfaqesues i RSH në NATO!**

Pyetje dhe përgjigje të shpeshta, VIRUSI DHE SËMUNDJA NGA COVID-19



Duke marrë shkak nga situata aktuale për arsye të kushteve të krijuara nga COVID19 dhe shpalljes së situatës pandemike nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, Kryesia e OBVL, këshillon të veteranut, pasardhësit dhe familjet e tyre, të tregohen maksimalisht të kujdesshëm me situatën e krijuar e në veçanti me:

-Larjen e shpeshtë të duarve dhe higjienizimi e tyre.

-Shmangjen e kontakteve sociale dhe nga afër me njerëzit.

Do të ishte me shumë dobi kujdesi i shtuar i çdo qytetari, familjari dhe një vëmendje të veçantë në drejtim të evitimit të kontakteve me të afërmit tanë.

1. ÇFARË ËSHTË KORONAVIRUSI?

Koronaviruset (CoV) janë një familje e madhe virusesh që shkaktojnë sëmundje nga më të lehtat deri tek ato tepër të rënda. Ato janë të përhapur në shumë lloje të kafshëve dhe rrallë evoluojnë, transmetohen, infektjnë njerëzit dhe më pas përhapen midis tyre. Koronaviruset humane u identifikuan për herë të parë në vitin 1960 dhe deri në vitin 2019 njiheshin 6 të tillë nga të cilët 4 të zakonshëm si: 229E (alpha coronavirus), NL63 (alpha coronavirus, OC43 (beta coronavirus) dhe HKU1 (beta coronavirus).

KORONAVIRUSI I RI COVID- 19

Në 31 dhjetor 2019, pati disa raste me pneumoni në Wuhan, provinca Hubei, Kinë ku shumica e tyre raportonin ekspozim në një treg të madh të produkteve të detit ku shiteshin shumë lloje të kafshëve të gjalla. Të dhënat paraprake tregojnë se 2019 – nCoV ka homologji për disa amino acide me SARS – CoV dhe mund të përdorë si receptor ACE2. Që prej 11 shkurt 2020 sëmundja e shkaktuar nga ky virus u quajt COVID-19 (CO- lidhet me Koronavirus; VI- lidhet me virusin; D-lidhet me sëmundjen

(Disease) dhe '19 lidhet me vitin) ndersa virusi u emërtuar SARS-CoV-2.

SI MUND TA MBROJ VETEN NGA KORONAVIRUSI I RI?

Koronavirusi shkakton simptoma tipike respiratore. Më poshtë paraqiten rekomandimet kryesore:

- Lani shpesh duart me ujë dhe sapun ose pastrojeni ato duke i fërkuar me pastrues me bazë alkooli;
- Kur kolliteni apo teshtini, mbuloni gojën dhe hundën me gropëzën e bërrylit ose shami letre. Hidheni menjëherë shaminë e letrës në koshin e plehrave dhe pastaj lani duart;
- Mënjaroni kontaktet e ngushta me këdo që ka temperaturë dhe kollë;
- Mbani një distancë të caktuar – të paktën një metër – nga njerëzit e tjerë, veçanërisht kur kolliten ose teshtijnë ose nëse kanë ethe, sepse virusi gjendet në spërklata e pështymës dhe mund të transmetohet nëpërmjet frymëmarrjes në distancë të afërt.
- Paraqituni tek mjeku nëse keni kollë, temperaturë apo vështirësi në frymëmarrje dhe raportoni historinë e udhëtimeve nëse keni udhëtuar kohët e fundit;

Mënjaroni kontaktet me tregjet e kafshëve të gjalla në zonat që kanë Koronavirus dhe parandaloni kontaktet e pambrojtura me kafshë të gjalla apo sipërfaqe që kanë qenë në kontakt me kafshët;

- Mënjaroni konsumin e produkteve të mishit të pagatuara apo gatuar jo shumë. Mishi, qumështi i papërpunuar apo organet e kafshëve duhet të trajtohen me kujdes, duke përdorur mjete mbrojtëse në mënyrë që të mënjanohet kontaminimi;
- Udhëtarët që kanë patur kontakte me raste të konfirmuara apo ekspozim direkt ndaj një burimi të mundshëm të infeksionit duhet të vendosen në observim mjekësor. Kontaktet me rrezik të lartë duhet të mënjanojnë udhëtimet për periudhën e inkubacionit deri në 14 ditë;
- Mos harroni se ka disa shkaktarë të sëmundjeve respiratore dhe Koronavirusi i ri mund të jetë njëri prej tyre. Nëse keni simptoma të lehta dhe nuk keni qenë kohët e fundit në Kinë, qëndroni në shtëpi derisa simptomat të lehtësohen duke zbatuar masa higjienike, të cilat përfshijnë higjienën e duarve dhe atë respiratore.